

KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot më datë 13/10/2022, palët e mëposhtme;

SHITESI: Z. Taulant HOXHA, shtetas shqiptar, i biri i Kadriut, lindur me datë 30.09.1972, banues në Durrës, identifikuar me letërnjoftimin me nr. Personal H209301310, madhor, me zotësi të plotë e për të vepruar (në cilësinë e Shitësit)

dhe
BLERESI: Aulona GAXHENJI, shtetase shqiptare e bija e Valentinit me nr. Personal I55703084S lindur me datë 03.07.1985, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar (në cilësinë e Blerësit)

vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga shitësi kundrejt blerësit, të 100 % (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë, që Shitësi zotëron në shoqërinë "SEAN" sh.p.k. me NUIS M11829504Q.

Neni 2

Përmbajtja e kontratës

Shoqëria "SEAN" sh.p.k., është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e krijuar më 29.06.2021 e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare dhe e regjistruar në Organet Tatimore me NUIS M11829504Q.

- (A) Shitësi, Z. Taulant HOXHA është aksionari i vetëm i shoqërisë "SEAN" sh.p.k. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e organizuar sipas legjislacionit Shqiptar, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS): M11829504Q, me seli në adresën DURRES Lagjja nr. 16, Rr. Hyen Kertusha, Objekti BIG BAR, Kati 4, me kapital themeltar tërësisht të nënshkruar dhe të shlyer prej 100 000 Lekë, (njëqind mijë Lekë) më poshtë quajtur "Shoqëria".
- (B) Shitësi është pronar dhe mbajtes i një kuote, me kapital të nënshkruar 100 000 Lekë, (njëqind mijë Lekë), që përfaqësojnë në total 100% të pjesëmarrjes së tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë, i cili është paguar tërësisht si rezulton dhe vërtetohet nga dokumentet e shoqërisë;
- (C) Shitësi dëshiron ti shesë Blerësit dhe Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi, përkatësisht 1 kuotë, që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- (D) Blerësi, Aulona Gaxhenji është e interesuar që të blejë kuotën, që përfaqëson në total 100% në kapitalin themeltar të Shoqërisë, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë kontratë.

Neni 3

Çmimi i shitjes

Pala Blerëse i paguan Palës Shitëse çmimin e shitjes 100.000 (njëqind mijë) Lekë për kuotën me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) Lekë që përfaqëson 1 kuotë dhe 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 4

Detyrimet e Palëve

Taulant Hoxha
SEAN sh.p.k.
NUIS: M11829504Q

(A) Kuotën e shitjes nga Pala Shitëse të Shoqërisë "SEAN" sh.p.k. dhe çdo e drejtë dhe detyrim i cili buron prej kuotës, i kalojnë/transferohen në pronësi Palës Blerëse -

Aulona Gaxhenji
[Signature]

Aulona GAXHENJI menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate nga Palët. Me nënshkrimin e kësaj kontrate nga palët, ortaku i vetëm i Shoqërisë "SEAN" sh.p.k., përkatësisht shitësi, humbet pronësinë dhe nuk do të jetë më zotërues/pronar i kuotës të shitur tek pala Blerëse - Aulona Gaxhenji dhe nuk ka dhe s'do të kenë asnjë pretendim lidhur me këtë.

(B) Zbatimi dhe ekzekutimi i kësaj Kontrate nga Shitësi nuk përbën shkelje të ndonjë norme, vendimi, urdhëri, vendimi gjyqësor, dekreti që i drejtohet Shitësit, apo që Shitësi është palë, apo që ka efekt mbi asetet e tij, pjesërisht apo tërësisht, apo që rezulton të krijojë ndonjë peng apo barrë mbi keto asete, përveç sa është parashikuar në këtë Marrëveshje.

(C) Pala Blerëse fiton pronësinë e kuotës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore të cilat kanë lindur përpara momentit të shitjes të këtyre kuotave dhe do të lindin në vazhdim si pasojë e zotërimit të kuotës, përfshirë detyrimet ndaj institucioneve shtetërore (tatim mbi vlerën e shitur, tatim mbi të ardhurat, tatim në burim, taksat dhe tarifat vendore, sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat, faturime nga OSHEE-ja dhe UKT-ja etj.); ndaj të tretëve, shoqërive tregtare dhe personave fizik (çdo e drejtë/detyrim i cili rrjedh nga kontratë qiraje, shërbimi, enfiteoze, leasing, kredi, huaje etj) apo çdo e drejtë/detyrim ndaj shoqërive tregtare dhe/ose organizate jo-qeveritare që Shoqëria "SEAN" sh.p.k., përfshirë çdo të drejtë/detyrim i/e cila nuk është përmendur shprehimisht në këtë kontratë dhe në mënyrë ligjore ose/dhe kontraktuale i takon palës Blerëse.

(D) Blerësi do të paguajë Çmimin e plotë të Blerjes në përputhje me këtë Kontratë. Blerësi deklaron dhe garanton se me nënshkrimin e kësaj kontrate njeh dhe pranon se është pajisur nga Shitësi me të gjithë dokumentacion e regjistrimit të Shoqërisë si dhe të aktivitetit të saj gjatë këtyre muajve.

Neni 5 Detyrimet e Palëve

Palët bien dakort që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e "Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë" mbi shitjen dhe Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 6 Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

Kjo kontratë hartohet në 4 kopje, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës, si dhe një kopje do të depozitohen në QKB.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI

"SEAN" sh.p.k

Ortaku

Taulant Hoxha

Taulant Hoxha



BLERËSI

Aulona Gaxhenji
GAXH